



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtushmërisë

“MENAXHIMI I PROJEKTEVE KAPITALE NË
FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË
MINISTRINË E KULTURËS, RINISË DHE
SPORTIT” PËR PERIUDHËN 2022-2024

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME	4
PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI	5
I.1. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	5
I.2. PERIUDHA E AUDITIMIT	5
I.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT	6
I.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT	6
I.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT	6
I.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	6
I.7. KRITERET E AUDITIMIT	7
PJESA III. GJETJET	8
PJESA IV. KONKLUZIONET	14
PJESA V. REKOMANDIMET	14
PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR	15

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik kryen auditime vjetore financiare dhe pajtueshmërisë të detyrueshme me ligj dhe auditime të performancës.

ZKA përmes auditimeve ofron informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do t'i shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ne përmes raporteve të auditimit kemi ofruar një pamje të qartë se si qeveria dhe institucionet publike kanë menaxhuar me shpenzimet dhe të ardhurat, pasurinë publike dhe qeverisjen në nivel të vendit.

Ne kemi vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, përdorimin e drejtë të burimeve dhe sistemeve tjera në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Fushë me rëndësi të cilës Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje çdo vit, është edhe ajo në menaxhimin e projekteve kapitale, kjo duke pasur parasysh që është ndër fushat kryesore të shpenzimit të parasë publike. Këto auditime kanë rol të rëndësishëm me ndikim që të rritet transparenca dhe efikasiteti në menaxhimin të projekteve kapitale si dhe me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së objekteve të trashëgimisë kulturore.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000). Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”.

Përbërja e ekipit të auditimit:

Shkëlqim Xhema, Drejtor i departamentit të auditimit;

Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit;

Fatlinda Podvorica, Anëtare e ekipit; dhe

Arian Zenelaj, Anëtar i ekipit.

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë me temën “Menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit”. Objektiva e këtij auditimi është të vlerësojë nëse projektet kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, janë planifikuar, zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive, efikase dhe në përputhje me ligjet dhe politikat përkatëse.

Subjekt i këtij auditimi ishte Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila përfshinë menaxhimin e projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore për periudhën janar 2022 deri në dhjetor 2024.

Buxheti i planifikuar për periudhën 2022-2024 ishte 27,153,500€, ndërsa realizimi në tri vitet ishte 10,891,418€. Kjo tregon një përqindje të ultë të shpenzimit në raport me buxhetin nëpër vite.

Konkluzioni i auditimit është se Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur të menaxhojë si duhet realizimin e projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore.

Ministria kishte angazhuar staf të pa licencuar në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore. Menaxherët e kontratave/organet mbikëqyrëse nuk kishin monitoruar si duhet menaxhimin e projekteve, pasi në disa raste nuk ishin plotësuar dhe nënshkruar me kohë ditarët e punës dhe librat ndërtimor, kishte mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive, nuk kishin aplikuar sistemin E-prokurimi, vonesa në realizimin e kontratave si dhe nuk kishin aplikuar garancion të punimeve pas pranimit teknik.

Për të eliminuar mangësitë e identifikuara, kërkohen veprime konkrete dhe për këtë kemi dhënë rekomandime për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI

I.1. MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) është institucion qeveritar, në kuadër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore, artistike dhe të trashëgimisë.

Qëllimi kryesor i saj është zhvillimi i artit dhe kulturës, ruajtja dhe restaurimi i trashëgimisë materiale e jo materiale, promovimi i vlerave kulturore brenda dhe jashtë vendit. Ndërsa, funksionet përfshijnë hartimin e strategjive kulturore, menaxhimin e trashëgimisë, mbështetjen e projekteve artistike dhe përfaqësimin ndërkombëtar.

Struktura organizative përbëhet nga Kabineti i Ministrit, drejtoritë e përgjithshme sipas fushave të veprimtarisë dhe institucionet vartëse si teatro, orkestrat, bibliotekat, muzeumet dhe galeritë.

MKRS synon ta mbrojë, ruajë dhe promovojë trashëgiminë kulturore të Kosovës në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe standardet evropiane.

Trashëgimia Kulturore e Kosovës është pjesë e rëndësishme e integritetit të Kosovës si shtet i pavarur dhe sovran.

Menaxhimi i projekteve të trashëgimisë kulturore bëhet nga departamenti për trashëgimi kulturore në kuadër të MKRS-së.

Gjatë periudhës 2022–2024, buxheti i planifikuar për projektet e trashëgimisë kulturore ka shënuar trend rritës, nga 5,438,000€ në vitin 2022, në 11,540,000€ në vitin 2024. Siç paraqitet në tabelën në vijim, janë pasqyruar të dhënat lidhur me buxhetin e planifikuar dhe shpenzimet e realizuara për projektet e trashëgimisë kulturore gjatë kësaj periudhe trevjeçare.

Viti	Buxheti i planifikuar (€)	Shpenzimet e realizuara (€)
2022	5,438,000	2,325,233
2023	10,175,500	2,517,012
2024	11,540,000	6,049,174

I.2. PERIUDHA E AUDITIMIT

Periudha e përfshirë në auditim është nga 01.01.2022 deri më 31.12.2024.

I.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka mandat kushtetues dhe ligjor, për t'i audituar programet dhe projektet e menaxhuara nga organizatat buxhetore dhe të financuara nga buxheti i Kosovës. Auditimi kryhet në bazë të paragrafi 2, nenit 21, të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

I.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130 Kodin e Etikës, 400 Parimet e auditimit të pajtueshmërisë, dhe 4000 Standardet e auditimit të pajtueshmërisë dhe manuali i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Dëshmitë e auditimit të mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionet e nxjerra në këtë raport.

I.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT

Këtu përfshihen informacionet për procesin e menaxhimit të projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si:

- Planifikimi i projekteve në fushën e trashëgimisë,
- Zbatimi apo realizimi i projekteve nëse janë duke u kryer punët sipas kontratës, dhe
- Monitorimi i projekteve kapitale në përputhje me ligjet dhe politikat përkatëse.

Gjatë këtij auditimi ne nuk kemi pasur ndonjë kufizim që do të ndikonte në punën tonë audituese.

Auditimi ka përfshirë periudhën 2022-2024, dhe është zhvilluar në MKRS, përkatësisht departamentin e trashëgimisë kulturore.

I.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Të përcaktojë shkallën e pajtueshmërisë së vendimeve dhe veprimtarisë së menaxhmentit me kërkesat e kuadrit ligjor përkatës, akteve të brendshme dhe kontratave në fushën e audituar: “Menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit” që:

- Të vlerësohet pajtueshmëria në planifikimin dhe aprovimin e projekteve;
- Të verifikohet nëse projektet janë realizuar në përputhje me kontratën; dhe
- Të analizohet efektiviteti i mbikëqyrjes dhe raportimit.

Qëllimi i auditimit ka qenë të vlerësojë nëse menaxhimi i projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore është zhvilluar në pajtim me ligjin dhe rregulloret, si dhe nëse fondet publike janë përdorur për qëllimet e planifikuara.

I.7. KRITERET E AUDITIMIT

Lista e ligjeve dhe rregulloreve me anë të të cilave rregullohen procedurat dhe menaxhimi i pronave të dhëna në shfrytëzim janë:

- Ligjin Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore;
- Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës me plotësim -ndryshim.
- Ligji Nr. 03.L-048 për menaxhimin dhe financave publike dhe përgjegjësitë me plotësim -ndryshim.
- Ligji Nr. 08/L-066 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2022 me plotësim ndryshime;
- Ligji Nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023 me plotësim ndryshime;
- Ligji Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2024.

Aktet nënligjore:

- Rregullorja e Nr. 001/2022 për Prokurim Publik;
- Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 02/2025 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për personat fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore.

PJESA III. GJETJET

ZKA, në auditimin e kryer ka identifikuar mangësi në procesin e menaxhimit të projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore nga ana e MKRS-së. Mangësitë e identifikuara pasqyrohen përmes gjetjeve të auditimit të cilat reflektojnë për mënyrën e menaxhimit duke filluar nga planifikimi i projekteve, zbatimi i kontratave dhe mbikëqyrja e tyre. Gjetjet e identifikuara bazohen në analizimin e dokumenteve relevante të pranuar nga MKRS. Në vijim shpalosim çështjet e identifikuara:

Çështja I: Angazhimi i stafit mbikëqyrës pa licencë në projektet e trashëgimisë kulturore

Kriteri:

Sipas nenit 4, paragrafi 4.16 të Ligjit Nr. 02/L-088 për Trashëgiminë Kulturore, veprimet konservuese dhe restauruese duhet të kryhen nga persona fizikë ose juridikë të licencuar nga Ministria, në përputhje me aktet nënligjore të bazuara në këtë ligj.

Gjithashtu, Udhëzimi Administrativ (MKRS) Nr. 02/2025 për kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin e licencave profesionale për personat fizikë dhe juridikë në fushën e trashëgimisë kulturore, përcakton se:

- Licenca AI u jepet personave fizikë për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në hartimin e projekteve për konservim/restaurim dhe mbikëqyrjen e implementimit të tyre (neni 5, pika 2.1).

Prandaj, caktimi i stafit pa këtë licencë është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjendja:

Në 10 projekte të testuara të restaurimit dhe konservimit të objekteve të trashëgimisë kulturore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kishte angazhuar zyrtar të ministrisë për hartimin dhe mbikëqyrjen e punimeve, pa poseduar licencë profesionale të lëshuar nga Ministria, siç kërkohet me ligj.

Shkaku:

Kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mungesës së stafit të brendshëm të licencuar dhe mos ndërmarrja e veprimeve nga MKRS për licencimin e stafit.

Ndikimi:

Angazhimi i stafit pa licencë për mbikëqyrje të punëve në trashëgimi kulturore rrit rrezikun që mbikëqyrja të mos kryhet në përputhje me kriteret e kërkuara, duke ndikuar në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e punimeve të konservimit dhe restaurimit.

Rekomandimi I:

Ministri duhet të sigurojë që në projektet e trashëgimisë kulturore të angazhohet vetëm staf i licencuar, në përputhje me kërkesat ligjore. Në mungesë të stafit të licencuar, duhet të ndërmerren masa për trajnimin dhe licencimin e personelit.

Çështja 2: Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit

Kriteri:

Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, neni 70, paragrafi 70.24.f. përcakton që: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Gjendja:

Në 10 kontrata të testuara, vërejtëm që menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar të dhënat e menaxhimit të kontratës përmes sistemit elektronik të prokurimit publik (E-prokurimi).

Shkaku:

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, dhe mungesës së njohurive ligjore nga menaxherët e kontratave.

Ndikimi:

Mos përdorimi i sistemit të E-prokurimit për mbajtjen dhe arkivimin e kontratave mund të ndikoj në mos respektimin e kërkesave ligjore si dhe pamundësinë që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe realizimin e kontratave.

Rekomandimi 2:

Ministri duhet të sigurojë që menaxhimi dhe arkivimi i të gjitha kontratave të bëhet përmes sistemit elektronik të prokurimit publik. Për këtë qëllim, duhet të forcohen kontrollet e brendshme dhe të ofrohen trajnime adekuate për menaxherët e kontratave, në mënyrë që të rritet pajtueshmëria ligjore dhe efikasiteti në menaxhimin e kontratave.

Çështja 3: Mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive (përgatitjen e paramasës)

Kriteri:

Rregullorja Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, neni 19, paragrafi 14, përcakton që, specifikat teknike për kontratat e punës duhet të përcaktojnë në mënyrë të saktë natyrën dhe karakteristikat e performancës së punëve të kërkuara. Specifikat teknike duhet të përfshijnë, si pjesë substanciale të vetën, një projekt ekzekutues.

Gjendja:

Lidhur me hartimin e projekteve dhe përgatitjen e paramasës kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- 1) Projekti “Faza e dytë në Kishën Katolike” në Ferizaj, me vlerë 1,288,745 €, është vërejtur se:
 - Në projekt ishin planifikuar 45 dritare të dimensioneve 80/140 por gjatë realizimit projekti kishte pësuar ndryshime me kërkesë të autoritetit të kishës, ku tri dritare ishin mbyllur. Menaxheri i kontratës dhe operatori ekonomik ishin dakorduar për kthimin e këtyre tri dritareve dhe zbritjen në situacionin e ardhshëm.
 - Për punët e fasadës ishin parashikuar 525 m², ndërsa ishin realizuar vetëm 367,5 m² aq sa ishte gjendja reale në teren. Pra sasia ishte projektuar gabimisht.
- 2) Projekti “Lagja e Hajdineve në Terizaj – Gjilan”, me vlerë 409,644 €, është vërejtur se:
 - Projekti kryesor i dorëzuar nga projektuesi përkatësisht njësia kërkuese nuk përfshinte punimet për punët e kanalizimit dhe elektrikës, dhe të njëjtat nuk ishin pjesë përbërëse e paramasës/parallogarisë përkatëse, mirëpo paramasa tjetër për zërat shtesë (kanalizimi dhe elektrika) në vlerë 27,355€ ishte dorëzuar veçmas nga ajo e projektit kryesor.

Shkaku:

Këto mangësi ishin si rezultat i planifikimit jo të saktë dhe mbikëqyrjes jo të mjaftueshme gjatë hartimit të projekteve dhe përgatitjes së paramasës nga njësitet e kërkesës.

Ndikimi:

Mospërputhja ndërmjet projektit ekzekutiv (paramasës) dhe gjendjes faktike në teren krijon paqartësi gjatë realizimit të punimeve, që mund të ndikojë në zbatimin joefikas të kontratës, vonesa në realizim dhe rritje të shpenzimeve të paplanifikuara.

Rekomandimi 3:

Ministri duhet të sigurojë që hartimi dhe aprovimi i projekteve ekzekutive bëhet në përputhje me nevojat reale, duke u siguruar që paramasat hartohen saktë dhe të pasqyrojnë gjendjen reale në terren.

Çështja 4: Mangësi në mbajtjen e ditarëve të punës dhe librave ndërtimor

Kriteri:

Në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës, pika II – Regjistri i punës, kontraktuesi është i detyruar të mbajë një regjistër pune në vend punishte, i cili duhet të përmbajë shënime të të gjitha elementeve sasore dhe cilësore për furnizimet e dorëzuara dhe të përdorura si dhe shënimet e bëra në regjistrin e punës, si punë në progres. Ditarët e punës dhe librat ndërtimor duhet të nënshkruhen nga autoriteti kontraktues dhe të bashkë nënshkruhen nga kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij.

Gjendja:

Në katër projekte të testuara, ditarët dhe librat ndërtimorë nuk ishin nënshkruar rregullisht nga organi mbikëqyrës në periudha të caktuara. Këto janë vërejtur te:

- Projekti “Restaurimi i ish gjimnazit të vjetër Ismajl Qemali (Jeronim De Rada)” Ferizaj. Po ashtu te ky projekt, punët shtesë të kryera nuk ishin evidentuar në libra dhe ditarë ndërtimorë, por vetëm në situacione të punëve të përfunduara;
- Projekti për “Shtëpinë e përsipirtshme” në Shtime;
- Projekti “Shtëpia e Hasan Fazlisë”; dhe
- Projekti “Ish ndërtesa e ambulantes” në Mitrovicë.

Shkaku:

Këto kishin ndodhur si rezultat i mos angazhimeve të duhura nga zyrtaret përgjegjës, dhe nga mosfunksionimi i kontrollit të brendshëm.

Ndikimi:

Mungesa e shënimeve dhe nënshkrimeve në ditarët e punëve dhe librat ndërtimor vështirëson kontrollin me kohë të punëve të kryera si dhe pagesave për ato punë.

Rekomandimi 4:

Ministri duhet të sigurojë që ditarët e punës dhe librat ndërtimor nënshkruhen rregullisht nga organi mbikëqyrës dhe punëkryesi, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës.

Çështja 5: Vonesa në realizimin e kontratës

Kriteri:

Në kushtet e veçanta të kontratës, pika 7, përcakton se, kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktues do të përgatisin një plan dinamik të azhurnuar për ekzekutimin e punimeve duke ju përmbajtur afateve kohore për ekzekutimin e kontratës përfshirë këtu metodologjinë e punës dhe orarin në muaj kalendarik për realizimin e secilës fazë të punimeve. Në kontratat e nënshkruara specifikohet afati për fillimin dhe përfundimin e punimeve.

Gjendja:

Në dy projekte kemi vërejtur vonesa në realizimin e punimeve:

1. Projekti “Konzervimi dhe restaurimi i ndërtesës së Muzeut Kombëtar të Kosovës - me vlerë 2,946,757€, kontrata ishte nënshkruar me datën 09.08.2024, ku afati i përfundimit të punimeve ishte paraparë me datën 09.09.2025. Megjithatë, deri në muajin korrik 2025 ishte realizuar afër 40% e punimeve.
2. Projekti “Intervenime emergjente në Qendrën Kulturore Hebraike në Prizren” në vlerë 547,557€, ishte nënshkruar me datë 17.10.2022, ku përfundimi i punimeve ishte 25 muaj nga nënshkrimi i kontratës. Për më shumë kontrata edhe në muajin korrik 2025 ende ishte aktive dhe punimet nuk kishin përfunduar.

Shkaku:

Këto vonesa kanë ndodhur si rezultat i pengesave të shkaktuara gjatë planifikimit dhe realizimit të punimeve si, ndryshimet dhe plotësimet e projektit bazë, pengesat tjera administrative të paplanifikuara gjatë realizimit të projekteve si dhe nga rrethanat tjera, siç janë faktorët natyrore, në rastin konkret dalja e ujërave nëntokësore.

Ndikimi:

Mos realizimi i punimeve sipas afateve të përcaktuara me kontratë rrit rrezikun që projektet të mos përfundojnë sipas afateve kontraktuale dhe të mos arrihen objektivat e planifikuara.

Rekomandimi 5:

Ministri duhet të forcoj kontrollet në monitorimin e projekteve kapitale duke ndërmarr masa për identifikimin e shkaqeve në vonesat e realizimit të projekteve si dhe eliminimin e tyre gjatë fazës së planifikimit apo realizimit të tyre.

Çështja 6: Mungesa e garancionit të punimeve pas pranimi teknik

Kriteri:

Sipas neni 29, paragrafi 6 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sigurimi i ekzekutimit do të mbetet valid për një periudhë prej tridhjetë (30) ditë pas kompletimit të kontratës. Ndërsa, në përputhje me kushtet e veçanta të kontratës, periudha garantuese e defekteve është dymbëdhjetë (12) muaj kalendarik nga data e pranimi teknik. Për sigurimin e cilësisë së punëve, kontraktori pas pranimi teknik duhet të ofrojë garancion bankar në vlerë 10% të kontratës, në kohëzgjatje një vit nga data e pranimi teknik.

Gjendja:

Në dy projekte të testuara kemi vërejtur se mungonte garancioni për punët e përfunduara pas pranimi teknik, si:

- Projekti "Restaurimi i ish gjimnazit të vjetër Ismajl Qemali (Jeronim De Rada) Ferizaj, në vlerë 499,999€, dhe aneks kontrata në vlerë 48,764€, ku pranimi teknik i punimeve ishte bërë me datë 03.11.2023, dhe
- Projekti "Lagja e Hajdineve në Terizaj – Gjiilan" vlerë 409,644€, ku pranimi teknik i punimeve ishte bërë me datën 14.08.2024.

Shkaku:

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mungesës së një sistemi të mirëfilltë të kontrollit për monitorimin e garancioneve nga ana e MKRS-së pas implementimit të kontratës.

Ndikimi:

Mos ofrimi i garancionit pas pranimi teknik rrit rrezikun që autoriteti kontraktues të mos jetë në gjendje të kërkojë kompensim në rast të defekteve që mund të paraqiten pas pranimi të punimeve.

Rekomandimi 6:

Ministri duhet të siguroj kontrolle efektive në mënyrë që të zbatohet kërkesa për dorëzimin e garancioneve bankare me kohë, sipas afateve të përcaktuara për të rritur sigurinë në realizimin e punimeve sipas cilësisë së kërkuar.

PJESA IV. KONKLuzionet

Bazuar në gjetjet e auditimit, konkludojmë se MKRS nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore dhe kontraktuale për menaxhimin e projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore.

Mungesa e veprimeve të duhura ka bërë që të paraqiten mangësi sa i përket angazhimit të stafit të pa licencuar nga MKRS në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, pastaj mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive, mbajtjen e ditarëve të punës dhe librave ndërtimor si dhe monitorimi i menaxhimit të kontratave nuk ishte bërë përmes sistemit E-prokurimi.

Dobësi janë evidentuar edhe në përmbushjen e afateve kontraktuale, në hartimin e planeve dinamike të realizimit si dhe mos siguri i garancioneve për punimet pas pranimit teknik.

Si rezultat i këtyre mangësive, menaxhimi jo efektiv i projekteve kapitale mund të ndikoj negativisht në sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e realizimit të projekteve të trashëgimisë kulturore, duke treguar nevojën për përmirësim të kontrolleve të brendshme, respektim rigoroz të procedurave ligjore dhe kontraktuale, si dhe përforcim të mbikëqyrjes profesionale.

PJESA V. REKOMANDIMET

Si rezultat i auditimit të kryer të pajtueshmërisë rekomandimet e mëposhtme i jepen Ministrit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Rekomandimet për Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit:

- Të siguroj, që në mbikëqyrje të realizimit të projekteve të trashëgimisë kulturore të angazhohet vetëm staf i licencuar, duke ndërmarrë masa për trajnimin dhe certifikimin e personelit në mungesë të stafit të licencuar.
- Të siguroj, që menaxherët e projekteve të përdorin sistemin elektronik të prokurimit publik për menaxhimin e kontratave, duke mundësuar mbikëqyrje të lehtë dhe transparente.
- Të siguroj, që hartimi dhe aprovimi i projekteve të bëhet në përputhje me nevojat reale, duke reflektuar saktë gjendjen në terren.
- Të siguroj kontrole adekuate për identifikimin e shkaqeve të vonesave në realizimin e projekteve si dhe eliminimin e këtyre pengesave qoftë në fazën e planifikimit apo realizimit të tyre.
- Të sigurojë që ditarët e punës dhe librat ndërtimor nënshkruhen rregullisht nga organi mbikëqyrës dhe punëkryesi, siç kërkohet nga legjislacioni përkatës.
- Të siguroj se garancionet bankare për punët pas pranimit teknik, zbatohen dhe dorëzohen në kohë për të garantuar realizimin e punimeve sipas cilësisë së kërkuar.

PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZORIT NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR/DORËZUAR: DATE RECEIVED/SUBMITTED: 14-11-2025			
Nësie Org. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. faqeve Br. Stranica No. Pages
03	47	2066	1



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT MINISTRY OF CULTURE, YOUTH & SPORTS	
Nr. Nj.	Shenja klas.
01	02
Nr. Prot. Viti	5945/2025
Data	13. 11. 2025
Nenshtkrimi	Prishtinë

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta -Ministry of Culture, Youth & Sports

Departamenti i Trashëgimisë Kulturore

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 2022-2024

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e pajtueshmërisë "Menaxhimin e projekteve kapitale në fushën e trashëgimisë kulturore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit" (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Hajrulla Ceka,

Ministër i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në detyrë

Data: 05. Nëntor 2025, Prishtinë

National Audit Office of Kosovo
Arbëria District,
St. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Pristina
Republic of Kosovo